



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 8 Gusht 2016
Nr. ref.: RK972/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI63/16

Parashtrues

Astrit Pira

Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës,
PN-II-.nr. 8/2015, të 26 nëntorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Astrit Pira nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga z. Mahmut Halimi, avokat në Mitrovicë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, PN-II-. nr. 8/2015 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), të 26 nëntorit 2015, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 15 dhjetor 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur nenet 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht *“ndalim të procedimit të mëtejshëm të rastit penal pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë nr. PKR 23/15”*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 13 prill 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 15 prill 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 6 maj 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 14 qershor 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 21 tetor 2010, Prokurori Special (në tekstin e mëtejme: PS) filloi hetimin e disa veprave penale.
11. Më 9 qershor 2011, PS-ja vendosi ta zgjerojë hetimin dhe ta përfshijë parashtruesin e kërkesës në hetim për veprat penale të furnizimit, transportit, prodhimit, shkëmbimit ose shitjes së armëve, krimit të organizuar, mashtrimit, keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar dhe keqpërdorimit të autorizimeve ekonomike.

12. Kohëzgjatja e hetimeve ishte zgjatur disa herë deri më 7 qershor 2013. Më 19 korrik 2013, PS-ja i pezulloi hetimet.
13. Më 19 janar 2014, PS-ja ka vendosur rifillimin e hetimeve dhe ka ngritur aktakuzë kundër parashtruesit të kërkesës (PPS 108/2010).
14. Avokati mbrojtës e kundërshtoi parashtrimin e aktakuzës, duke pretenduar se aktakuza është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me nenin 159 të KPP-së.
15. Më 28 maj 2015, Gjykata Themelore (Aktvendimi nr. PKR 23/15, PPS: 108/10) vendosi të pranojë vërejtjet e avokatit mbrojtës dhe hodhi poshtë aktakuzën si të paafatshme.
16. PS parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar se *“nuk ka afat ligjor për ngritjen e aktakuzës dhe prokurori mund të ngrit aktakuzën në çdo kohë – me të vetmin kufizim të afatit të parashkrimit”*.
17. Më 19 gusht 2015, Gjykata e Apelit (Aktvendimi PN 340/15), e refuzoi si të pabazuar ankesën e PS.
18. Gjykata e Apelit arsyetoi se *“Gjykata Themelore në detaje e ka analizuar procedurën faktike dhe gjendjen juridike. Kolegji është plotësisht i bindur me konkluzionet dhe arsyetimin e Gjykatës Themelore. Kolegji për këtë arsye plotësisht pajtohet me këtë arsyetim dhe e vërteton konkluzionin në tërësi”*.
19. Gjykata e Apelit konkludoi: *“Në bazë të nenit 159 para. 1 të KPP-së, hetimi në fjalë ose duhet të përfundojë brenda afatit prej 2 (dy) vjetësh me ngritjen e menjëhershme të aktakuzës ose hetimi në fjalë duhet të pezullohet automatikisht. Në bazë të nenit 68 të KPP-së, ndërprerja e hetimeve nënkupton ndërprerjen e tërë procedurës, pasi që një fazë procedurale nuk pasohet nga faza tjetër e radhës. Në lëndën në fjalë, afati i hetimit kishte skaduar para se prokuroria ta ngre aktakuzën. Si pasojë e kësaj, prokurori e ka ngritur aktakuzën pasi tashmë ishte ndërprerë procedura penale, që është e kundërligjshme”*.
20. Më 22 shtator 2015, PS parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme, duke pretenduar si në vijim:

“Vendimi i kundërshtuar shkel të drejtën e siguruar nga pala nën Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe po ashtu të drejtën themelore të siguruar për palën sipas KPP, dhe të drejtën themelore të siguruar për palën sipas një ligji tjetër të Kosovës, më saktësisht, neni 109 paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 4 paragrafi 2 dhe neni 7 paragrafi 1 nënparagrafët 1.7 dhe 1.8 të Ligjit mbi Prokurorin e Shtetit, dhe neni 49 i KPP (Neni 415 paragrafi 1 nënparagrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPP), dhe e drejta procedurale me qëllim të garantimit të drejtës nën nenin 415 paragrafi 1 nënparagrafët 1.1 deri 1.3 të KPP (Neni 415 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 i KPP). Më saktësisht, Vendimit të kundërshtuar i mungon arsyetimi në çështjen vendimtare, sipas nenit 404 paragrafi 1 i KPP (Neni 384 paragrafi 1

nënparagrafi 1.12 i KPP), dhe Gjykata e Apelit aplikoi dispozitat e nenit 68, nenit 158 paragrafi 3, dhe neni 253 paragrafi 1 i KPP gabimisht, nuk arritën të marrin në konsideratë nenin 4 paragrafi 1 dhe nenin 240 paragrafi 1 i KPP, dhe Vendimi i Kundërshtuar është në kundërshtim esencial të dispozitave të procedimeve penale (neni 384, paragrafet 2, nënparagrafi 1 i KPP)”.

21. Më 26 nëntor 2015, Gjykata Supreme (Aktvendimi PN. II. nr. 8/2015) e aprovoi ankesën e PS dhe ndryshoi Vendimin e Gjykatës së Apelit.
22. Gjykata Supreme arsyetoi si në vijim:

“Është e qartë dhe e pafat që afati për ngritjen e aktakuzës nuk është përcaktuar në mënyrë specifike në KPP-në. Madje asnjë dispozitë e KPP-së nuk tregon hollësisht asnjë rrethanë kur aktakuza është e “paafatshme”, ose për hedhjen poshtë të aktakuzës mbi këtë bazë. Kolegji fillimisht e mori parasysh nenin 68 të KPP-së i cili cakton hollësisht katër fazat e ndryshme të procedurës penale: fazën e hetimit, fazën e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit fazën e shqyrtimit gjyqësor dhe fazën e mjetit juridik. Me këtë dallim të qartë të fazave të procedurës penale në KPP, kolegji gjen se qëllimi i ligjvënësit është i qartë se ngritja e aktakuzës hyn në fazën e dytë të procedurës penale (fazën e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit) e jo në fazën e parë (fazën e hetimit). Kjo pikëpamje është e përforcuar me nenin 159 të KPP-së. Ky nen është shumë i qartë sa i përket afateve kohore të fazës së hetimit, dhe nuk përfshin asnjë dispozitë që përcakton se ngritja e aktakuzës duhet të bëhet brenda afatit të lejuar. Kolegji pastaj e mori parasysh nenin 240 KPP-së, me të cilin caktohen hollësisht veprimet që Prokurori i ka në dispozicion pasi hetimi të ketë përfunduar. Paragrafi I përcakton procedurën para gjykatës në bazë të aktakuzës së ngritur nga Prokurori i Shtetit, dhe paragrafi 2, përndryshe, përcakton se Prokurori i Shtetit nxjerr aktvendim për pushimin e hetimit. Të dyja situatat shprehimisht i referohen përfundimit të hetimit, dhe kolegji mendon se kuptimi i nenit është se ngritja e aktakuzës nuk është pjesë e fazës së hetimit dhe prandaj nuk i nënshtrohet afateve kohore të përcaktuara me nenin 159 të KPP-së. Po ashtu është logjike që Prokurori i Shtetit nuk do të jetë në gjendje të marrë vendim se çfarë veprimesh të ndërmarë - të ngre aktakuzë apo të nxjerrë aktvendim. Po ashtu është e qartë se aktakuzat janë në mënyrë tipike dokumente të gjata dhe të hollësishme, që pashmangshëm marrin shumë kohë për t'u përgatitur me saktësi dhe plotësisht. Kolegji me shumicë votash konstaton se nuk ka afat kohor për ngritje të aktakuzës. “Aktakuza e paafatshme” nuk është paraparë me anë të KPP-së. Prokurori i Shtetit është i kufizuar vetëm me anë të parashkrimit të veprës penale në fjalë. Megjithatë, Prokurori i Shtetit rekomandohet qartë të ngre aktakuzë, kur një e tillë do të ngrihet sa më parë pas përfundimit të hetimit, pasi rreziku për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë brenda kohës se arsyeshme rritet me kalimin e kohës. Për më shumë, çdo gjykatë me rastin e vendosjes mbi meritat e akuzës penale me rastin e vendimit mbi dënimin gjithmonë do ta merr parasysh kohëzgjatjen e procedurës penale, në tërësinë e saj”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon *“cenimin e të drejtave individuale të parashtruesit të garantuara me nenet 29, 30 dhe 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 6 të Konventës Evropiane”*.
24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme ia mohoi parashtruesit të kërkesës të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sepse *“Kodi i Procedurës Penale ka paraparë afate prekluzive, me efekt të humbjes së të drejtës për ngritje të aktakuzës, nëse prokurori nuk ngre aktakuzë brenda periudhës 2 (dy) vjeçare, llogaritur nga dita e Aktvendimit për fillimin e hetimeve”*.
25. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, pretendon se *“vendimi i kundërshtuar i mungon arsyetimi për këtë çështje vendimtare, sipas nenit 404 paragrafi 1 të KPP (Neni 384, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 i KPP)”*.
26. Parashtruesi i kërkesës, më tej, pretendon se Gjykata Supreme vendosi *“në shkelje të sundimit të ligjit dhe parimit së sigurisë juridike sepse nëse nuk merren parasysh qëndrimet dhe standardet e vendimmarrjes të Gjykatës Supreme, si në rastin konkret, atëherë palët nuk mund të dinë se si të mbështeten në Kushtetutë, ligj dhe praktikën gjyqësore”*.

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:
 1. *Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
(...)
 7. *Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*
29. Gjykata i referohet edhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.
30. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] (1) (d) dhe (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, i cili specifikon:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(...)

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

(...)

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

31. Gjykata rikujton se parashtruesi pretendon se me vendimin e kontestuar pretendohet të jenë shkelur të drejtat e tij për liri dhe siguri, të drejtat e tij të akuzuarit dhe e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me Kushtetutë.
32. Gjykata është e vetëdijshme për dispozitat e referuara kushtetuese të neneve 29, 30 dhe 31 të Kushtetutës, si në vijim:
33. Neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë]

1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:

(1) pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;

(2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një veprë tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;

(3) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij/saj në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm;

(4) për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë;

(5) për hyrje të paligjshme në Republikën e Kosovës ose pas urdhrit të ligjshëm për largim ose ekstradim.

2. Çdokush që privohet nga liria, duhet të vihet në dijeni menjëherë, për arsyet e privimit, në gjuhën që ajo/ai e kupton. Njoftimi me shkrim mbi arsyet e privimit duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur. Çdokush që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës, brenda dyzet e tetë (48) orësh duhet të dërgohet përpara gjyqtarit, i cili vendos për paraburgimin ose lirimin e tij/saj, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur personi i privuar është sjellë para gjykatës. Çdokush që arrestohet, ka të drejtën që të nxirret në gjykim brenda një periudhe të arsyeshme, ose të lirohet në pritje të gjykimit, me përjashtim kur gjyqtari konstaton se personi përbën rrezik për komunitetin ose ka rrezik për ikjen e saj/tij para gjykimit.

3. Çdokush që privohet nga liria, duhet të njoftohet menjëherë se ka të drejtë të mos japë asnjë deklaratë dhe se ka të drejtë për mbrojtës sipas zgjedhjes së tij/saj dhe ka të drejtë që pa vonesë të informojë për këtë personin sipas zgjedhjes së vet.

4. Çdokush që i hiqet liria me arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të

shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit.

5. Çdokush që është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, gëzon të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligj.

6. Personi që vuan dënimin, ka të drejtë të ankohet për kushtet e privimit nga liria, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

34. Neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit]

Çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:

(1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër saj/tij;

(2) të njoftohet për të drejtat e tij/saj sipas ligjit;

(3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;

(4) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi;

(5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas;

(6) të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet.

35. Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medie, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.

7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.

36. Gjykata rikujton se argumenti kryesor i parashtruesit të kërkesës është nëse ngritja e aktakuzës 2 (dy) vjet pas fillimit të hetimeve është apo jo në pajtim me

ligjin penal. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e kontestuara janë shkelur *“Neni 109, paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 4, paragrafi 2 dhe neni 7, paragrafi 1 nënparagrafët 1.7 dhe 1.8 të Ligjit mbi Prokurorin e Shtetit, dhe neni 49 i KPP (Neni 415 paragrafi 1 nënparagrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPP), dhe e drejta procedurale me qëllim të garantimit të drejtës nën nenin 415 paragrafi 1 nënparagrafët 1.1 deri 1.3 të KPP (Neni 415 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 i KPP)”*.

37. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës ankohet se Gjykata Supreme gabimisht e ka interpretuar ligjin në lidhje me afatin për ngritjen e aktakuzës dhe konsideron se Gjykata Supreme duhej të kishte interpretuar dispozitat përkatëse ligjore në një mënyrë tjetër.
38. Gjykata vëren se Gjykata Supreme kishte marrë parasysh aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit. Pastaj, Gjykata Supreme ka filluar që të analizojë çështjen nga vrojtimi që *“asnjë dispozitë e KPP-së nuk tregon hollësisht asnjë rrethanë kur aktakuza është e “paafatshme”, ose për hedhjen poshtë të aktakuzës mbi këtë bazë”*. Pastaj, ajo diskutoi interpretimin e nenit 68, 159 dhe 240 të Kodit të Procedurës Penale dhe konsideroi se *“ngritja e aktakuzës (...) nuk i nënshtrohet afateve kohore të përcaktuara me nenin 159 të KPP-së. Në fund, Gjykata Supreme konkludoi se “nuk ka afat kohor për ngritje të aktakuzës. “Aktakuza e paafatshme” nuk është paraparë me anë të KPP-së”*.
39. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës e bazon pretendimin e tij mbi aplikimin e gabuar të neneve 68, 159 dhe 240 të Kodit të Procedurës Penale të bërë nga Gjykata Supreme në lidhje me ngritjen e aktakuzës nga PS 2 (dy) vjet pas fillimit të hetimeve. Ky argument procedural, ka të bëjë me fushën e ligjshmërisë dhe si i tillë nuk bie nën juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese dhe në këtë mënyrë nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata. Nga ana tjetër, Gjykata nënvizon se *“mosrespektimi i afatit të parashikuar me ligjin e brendshëm në vetvete nuk bie në kundërshtim me nenin 6 § 1 të Konventës”*. (Shih GJEDNJ, Mitkus kundër Letonisë, Kërkesa nr. 7259/03, Aktgjykim i 2 tetorit 2012, para. 88)
40. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), nëse përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend se një tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të ishte mos marrje parasysh të kufijve të vendosura në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I; rasti nr. KI72/14, parashtruese e kërkesës *Besa Qirezi*, Aktgjykim i 4 shkurtit 2015, para. 65).
41. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka paraqitur faktet të cilat e arsyetojnë pretendimin e tij për shkelje të së drejtës për liri dhe siguri, të drejtat të akuzuarit dhe të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dhe as

nuk ka dëshmuar shkeljen e pretenduar të së drejtave kushtetuese të thirrura nga ai.

42. Në të vërtetë, Gjykata vëren se parashtruesi nuk i referohet ndonjë fakti relevant dhe përkatës ose situatave që kanë të bëjnë me të qenit *i privuar nga liria*, të cilat bien nën nenin 29 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së; në lidhje me një akuzë penale, e cila mund të justifikojë gëzimin e *të drejtave minimale*, siç përcaktohet me nenin 30 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; dhe në lidhje me një *dëgjim publik*, siç përcaktohet me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
43. Gjykata konsideron se ky vlerësim është në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, sipas së cilës qëllimi i përgjithshëm i nenit 5 të KEDNJ-së është që të sigurojë që askush nuk duhet të privohet nga liria e tij në mënyrë arbitrare (*Assanidze kundër Gjeorgjisë*, Kërkesa nr. 71503/01, Aktgjykim i 8 prillit 2004). Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, neni 6 i KEDNJ-së fillon të zbatohet kur një hetim penal ka arritur pikën ku parashtruesi i kërkesës akuzohet për një vepër penale (*Zaprianov kundër Bullgarisë*, kërkesa nr. 41171/98, Aktgjykim i 30 shtatorit 2004). Përveç kësaj, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në veçanti konstatohet se garancia e siguruar me nenin 6 të KEDNJ-së kërkon që mbajtja e një dëgjimi nënkupton edhe seancën gojore.
44. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar dhe dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë e tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur nga interpretimi që pretendohet të jetë i gabuar i neneve 68, 159 dhe 240 të Kodit të Procedurës Penale. Gjykata thekson se interpretimi i neneve 68, 159 dhe 240 të Kodit të Procedurës Penale është çështje e ligjshmërisë. Asnjë çështje kushtetuese nuk është vërtetuar dhe dëshmuar nga parashtruesi i kërkesës.
45. Gjykata thekson se, si rregull i përgjithshëm, interpretimi i ligjit është ekskluzivisht çështje e gjykatave të rregullta, të gjeturat dhe konkluzionet e të cilave në këtë drejtim janë detyruese për Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë, kur vendimi i gjykatës së rregullt është qartazi arbitrar, Gjykata mund dhe duhet ta shqyrtojë atë (Shih, *Sisojeva dhe të tjerët kundër Letonisë* [DHM], kërkesa nr. 60654/00, Aktgjykimi i 15 janarit 2007, paragrafi 89).
46. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit; megjithatë, mospajtimi nuk mund t'i shërbejë atij si e drejtë të ngre kërkesë të argumentueshme për shkelje të neneve 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës (Shih për shembull rastin të Gjykatës Kushtetuese nr. KI125/11, *Shaban Gojnovci*, Aktvendim për papranueshmëri i 28 majit 2012, paragrafi 28).
47. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të parapara më tej me Ligj dhe me Rregulloren e punës.

48. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, ajo është e papranueshme.

Kërkesa për masë të përkohshme

49. Gjkata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata që të nxjerrë vendim për vendosjen e masës së përkohshme, përkatësisht *“Ndalimi i procedimit të mëtejshëm të rastit penal pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Nr. PKR 23/15”*.
50. Gjykata sapo ka konkluduar se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe është e papranueshme.
51. Prandaj, në pajtim me nenin 27.1 të Ligjit dhe rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme, refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 27.1 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 55 (4) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 14 qershor 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Almiro Rodrigues



Arta Rama-Hajrizi